

# Menaxhimi i Mbeturine Detare

## MARRËVESHJET FINANCI MI PËR FONDE TË VOGLA

### Konteksti i projektit

Marrëveshja për financimin e shkallës së vogël midis Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Institutit të Kërkimeve Urbane është pjesë e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet UNEP / MAP 2016-2021 dhe Ministrisë Italiane të Mjedisit, Tokës dhe Detit. Marrëveshja parashikon një projekt pilot për menaxhimin e mbeturinave detare në Shqipëri, i cili shërben për zbatimin e Planit Rajonal për Menaxhimin e Mbeturine Detare në Mesdhe, i zhvilluar nën Protokollin për mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotjet e veprimtarive të vendosura në tokë, në kuadër të Konventës së Barcelonës. Shqipëria si palë aderuese në këtë konventë duhet të zbatojë masat e parashikuara në Planin Rajonal.

### Qëllimi dhe objektivi i projektit

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është arritja e një statusi të mirë mjedisor të Detit Mesdhe dhe bregdetit të tij nëpërmjet rritjes së menaxhimit të mbeturinave detare përmes:

- parandalimi i gjenerimit të mbeturinave detare;
- zvogëlimi në minimum ndotjen nga mbeturinat detare në Mesdhe;
- të largohen mbeturinat ekzistuese detare;
- menaxhimin e mbeturinave detare në detin Mesdhe në përputhje me standardet dhe qasjet e pranuar ndërkombëtare dhe rajonale.



### Përfituesit e projektit

Përfituesi i këtij projekti është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

### Aktivitetet

Aktivitetet e mëposhtme janë pjesë e projektit:

- Promovimi i nismës “Adopto një Plazh”, pastrimi, mbledhja dhe vlerësimi i të dhënave për mbetjet e grumbulluara në dy plazhe:
  - Grykëderdhja e lumit të Bunës dhe Kepi i Rodonit
- Analiza e kuadrit ligjor Shqiptar për paketimet plastike një përdorimshe.
- Përmirësimi i grumbullimit dhe riciklimit të shisheve plastike PET
- Rritja e kapaciteteve lokale dhe kombëtare dhe ngritja e vetëdijes së palëve të interesit mbi ndikimin e mbeturinave në zonën bregdetare.

### Dimensioni mjedisor

Projekti do të ndikoj në rritjen e ndërgjegjësimit të autoriteteve kombëtare, lokale si dhe qytetarëve lidhur me ndikimin që kanë mbetjet në zonën bregdetare dhe detin Mesdhe. Projekti gjithashtu do të ndihmojë në përmirësimin e menaxhimit të

mbeturinave nga paketimet plastike dhe do të propozoj alternativa efikase

### Faktet kryesore

#### PARTNERËT

- Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

#### KOHËZGJATJA

- Maj 2018 - Qershor 2019

#### BASHKËPUNËTORË

- EcoVolis
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Bashkia Shkodër dhe Durrës

#### KONTAKT:

Zana Vokopola  
Drejtore Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. “Asim Vokshi”, Ndërtesa 14  
Hyrja 11, Ap. 56  
Tiranë  
Tel: +355 4 2256840  
E-mail: [zvokopola@uri.org.al](mailto:zvokopola@uri.org.al)  
Rrjet: [www.uri.org.al](http://www.uri.org.al)

për kapjen e produktit të paketimeve plastike e veçanërisht të shisheve plastike PET.

### Rreth IKU

Që prej vitit 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) realizon projekte dhe programe zhvillimi në të gjithë Shqipërinë, nëpërmjet të cilëve analizon problemet socio-ekonomike të vendit dhe politikat qendrore e vendore që hartohen për zgjidhjen e tyre. Misioni i IKU-t në këtë sipërmarrje është rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe zhvillimi i të menduarit kritik mbi këto probleme dhe ndikimin e politikave qeveritare, me qëllimin përfundimtar përmirësimin e cilësisë së vendim-marrjes dhe zbatimit në nivelin e qeverisjes qendrore e vendore. IKU punon me donatorë e partner si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, DLDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëri e Hapur etj.